



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

MIRATOHET

MINISTRI

MYQEREM TAFAJ

STATUTI

I

INSTITUTIT TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

TIRANË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Krijimi

Instituti i Zhvillimit të Arsimit (më poshtë IZHA) është institucion publik në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. IZHA është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.67, datë 10.02.2010 “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”.

Neni 2

Personaliteti juridik, selia dhe vendndodhja

IZHA organizohet dhe funksionon në bazë të Kushtetutës, të Ligjit nr.7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, të Ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.67, datë 10.02.2010 “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit” dhe të këtij statuti. IZHA është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me seli në rrugën “Naim Frashëri”, nr.37, Tiranë.

Neni 3

Misioni dhe objekti i veprimtarisë

1. IZHA i ofron Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve arsimore në vend ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-shkencore dhe praktikës arsimore.
2. IZHA ka për objekt të veprimtarisë së saj hartimin e kurrikulës për sistemin arsimor parauniversitar, zhvillimin e politikave të arsimit parauniversitar dhe atij të lartë, përgatitjen e dokumenteve të ndryshme në lidhje me politikat kombëtare në fushën e arsimit dhe kryerjen e punëve kërkimore studimore në fushat e didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

KREU II
ORGANIZIMI

Neni 4

Detyrat

1. Instituti i Zhvillimit të Arsimit ka për detyrë:

- a) Të përgatitë produkte në fushën e arsimit dhe të ofrojë ekspertizë për strukturat politikëbërëse dhe vendimmarrëse për politika arsimore dhe reforma në fushën e arsimit;
- b) Të zhvillojë punë kërkimore studimore, si dhe të ofrojë ekspertizë e këshillim për institucionet arsimore të të gjitha niveleve në fushat e didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimit në tërësi;
- c) Të mbështesë MASH-in në hartimin e studimeve, analizave periodike, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;
- d) Të ofrojë këshillim për nxënësit dhe qytetarët në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;
- e) Të zhvillojë metodologji për sigurimin e cilësisë e vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe programet e tyre mësimore;
- f) Të zhvillojë programe dhe standarde për kualifikimin e mësuesve, profesoratit dhe drejtuesve të institucioneve arsimore;
- g) Të zhvillojë metodologji dhe standarde për tekstet mësimore;
- h) Të zhvillojë veprimtari informative për institucionet, nxënësit, studentët, punëdhënësit dhe punëmarrësit;
- i) Të realizojë botime në përputhje me misionin dhe objektivat e saj;
- j) Të kryejë detyra të tjera që i ngarkohen nga qeveria dhe MASH brenda misionit të tij.

2. IZHA i raporton Ministrit të Arsimit dhe Shkencës në lidhje me:

- a) veprimtarinë, zbatimin e planeve të punës, realizimin e programeve, të ekspertizave dhe këshillimeve me nivel të lartë profesional, që ka në misionin e saj;
- b) ecurinë e zbatimit të buxhetit;
- c) efikasitetin dhe rezultatet e veprimtarive të saj;
- d) shkallën e përmbushjes së synimeve dhe objektivave të planit vjetor.

3. IZHA i bën propozime dhe këshillon Ministrin e Arsimit dhe Shkencës për:

- a) përmirësimin dhe formulimin e politikave arsimore;
- b) ndryshime në legjislacionin arsimor, rishikimin e strategjive arsimore dhe vendimmarrjet në fushën e reformave arsimore;
- c) studime dhe kërkime në fushën e zhvillimit të kurrikulës;
- d) studime në fushat e didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

4. IZHA bashkëpunon me drejtoritë e MASH-it në kryerjen e detyrave dhe realizon me të veprimtari të përbashkëta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 5

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

1. IZHA bashkëpunon me institucionet e varësisë së MASH-it për bashkërendimin dhe koordinimin e aktiviteteve.
2. IZHA bashkëpunon edhe me institucionet e tjera publike dhe jopublike brenda dhe jashtë vendit për të bërë të mundur plotësimin e objektivave dhe funksioneve të saj.
3. IZHA organizon takime, simpoziume, konferenca për të informuar grupet e interesit rreth studimeve dhe gjetjeve të kryera.
4. IZHA mbledh me kujdes të dhëna të hollësishme dhe përhap praktikatat e suksesshme të institucioneve dhe individëve duke e bërë këtë në mënyrë të posaçme, nëpërmjet botimeve apo faqes së saj zyrtare në internet.

KREU III

STRUKTURA, ORGANIKA DHE PUNËSIMI

Neni 6

Organizimi i brendshëm

Struktura dhe organika e IZHA-s përcaktohen me Urdhër të Kryeministrit.

Neni 7

Struktura

1. IZHA drejtohet nga drejtori i saj. Struktura e IZHA-s përbëhet nga:
 - a) Drejtorja e Zhvillimit të Politikave Arsimore, e cila përbëhet nga:
 - Spektori i Zhvillimit të Politikave të Arsimit Parauniversitar;
 - Spektori i Zhvillimit të Politikave të Arsimit të Lartë.
 - b) Drejtorja e Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit, e cila përbëhet nga:
 - Spektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Standardeve;
 - Spektori i Kualifikimit dhe Karrierës.
 - c) Drejtorja e Metodologjisë dhe Teknologjisë në Mësimdhënie, e cila përbëhet nga:
 - Spektori i Metodologjisë së Mësimdhënies;
 - Spektori i Teknologjisë në Mësimdhënie.
 - d) Spektori i Shërbimeve Mbështetëse.

Neni 8

Personeli

1. Personeli i IZHA-s përbëhet nga personeli shkencor dhe personeli administrativ-mbështetës.
2. Personeli shkencor kryen veprimtari kërkimore shkencore, shërbime për zhvillim të institucionit, konsultim dhe këshillim për nxënësit dhe qytetarët në fushën e arsimit në të gjitha nivelet dhe detyra administrative.
3. Personeli shkencor përbëhet nga:
 - a) drejtori;
 - b) drejtorë drejtorie;
 - c) përgjegjës sektori;
 - d) specialistë kërkimorë.
4. Personeli administrativ ushtron funksione administrative që kanë lidhje me veprimtarinë e institucionit.
5. Personeli administrativ përbëhet nga:
 - a) sekretari;
 - b) specialist finance;
 - c) specialist jurist;
 - d) magazinier;
 - e) pastruese.

Neni 9

Drejtori

Drejtori i IZHA-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Vendimin nr.173, datë 07.03.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

Neni 10

Funksionet e drejtorit

1. Drejtori i IZHA-s është autoriteti përgjegjës për drejtimin dhe organizimin e veprimtarisë së IZHA-s në bazë të Kushtetutës, legjislacionit në fuqi, VKM nr.67, datë 10.02.2010 “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit” dhe të këtij statuti.
2. Drejtori i IZHA-s përfaqëson IZHA-n në marrëdhënie me të tretët, qofshin këta persona fizik apo juridik, vendas apo të huaj.
3. Detyrat e drejtorit të IZHA-s përcaktohen në rregulloren e institucionit.

Neni 11

Bordi Editorial dhe detyrat e tij

1. Pranë IZHA-s ngrihet dhe funksionon Bordi Editorial. Kryetari i Bordit Editorial është drejtori i IZHA-s. Anëtarët e Bordit Editorial janë drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve në IZHA.
2. Bordi Editorial përcakton kriteret për vlerësimin dhe përzgjedhjen e artikujve që do të botohen në organet e IZHA-s.
3. Bordi Editorial përzgjedh titujt për botim dhe mbikëqyr procesin e përgatitjes së tyre.
4. Në fillim të çdo viti, Bordi Editorial harton një plan pune të detajuar, në të cilin përshkruhen dokumentet apo produktet e parashikuara për botim. Drejtori i IZHA-s merr masat e nevojshme për ndjekjen, zbatimin dhe realizimin e botimeve.

Neni 12

Rregullimi i marrëdhënieve të punës

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të IZHA-s rregullohen në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 13

Parimet e marrëdhënies së punës

1. Marrëdhëniet juridike të punës në Institutin e Zhvillimit të Arsimit bazohen në këto parime themelore:
 - a) Ndalimin e çdo lloj diskriminimi në lidhje me rekrutimin, ushtrimin e profesionit, ngritjen në detyrë dhe garantimin e të gjitha të drejtave të tjera që u njihen punonjësve në legjislacionin shqiptar;
 - b) Parimin e drejtësisë dhe të paanësisë: çdo anëtar i stafit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit trajtohet në mënyrë të ndershme dhe të paanshme;
 - c) Parimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet njësive organizative dhe anëtarëve të stafit të punësuar me qëllim sigurimin e efektivitetit në punë;
 - d) Parimin e përgjegjshmërisë: çdo anëtarë i stafit ka përgjegjësi për punën e kryer, për dhënien e informacioneve shkresore, për dëmet që mund t'i shkaktojë institucionit, individit apo çdo subjekti tjetër.

Neni 14

Kërkesa të përgjithshme të punonjësit

1. Punonjësi i punësuar në IZHA duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
 - a) të ketë arsimin e duhur për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës;
 - b) të zotërojë aftësi profesionale të nevojshme për vendin e punës;
 - c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;

Neni 15

Parimet bazë për punësimin e specialistëve

1. Pranimi në IZHA kryhet nëpërmjet seleksionimit dhe përzgjedhjes, bazuar në merita dhe aftësi, si dhe në garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë personat që plotësojnë kriteret e paracaktuara.
2. Për plotësimin e vendeve të punës në IZHA, kanë të drejtë të konkurrojnë të gjithë personat që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.
3. Procedura e punësimit përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 16

Emërimi dhe lirimi

1. Punësimi në Institutin e Zhvillimit të Arsimit mbështetet në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në këtë statut dhe në rregulloren e IZHA-s.
2. Emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve në Institutin e Zhvillimit të Arsimit bëhet nga drejtori i IZHA-s.

Neni 17

Fillimi i marrëdhënieve të punës

1. Fillimi i marrëdhënieve të punës konkretizohet me aktin e emërimit në detyrë dhe më tej me nënshkrimin e një kontrate individuale, mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Kontrata individuale e punës bëhet me shkrim dhe firmoset nga palët.
2. Në fillim, kontrata individuale e punës lidhet për një periudhë prove tre mujore. Kontrata mund të rinovohet bazuar në vlerësimin e performancës së punonjësit. Me këtë rast nënshkruhet një kontratë individuale pune me afat të përcaktuar apo të pacaktuar.

Neni 18

Konflikti i interesit

Çdo punonjës i IZHA-s duhet të zbatojë ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Punonjësit e IZHA-s nuk duhet të angazhohen në veprimtari të jashtme, që pengojnë kryerjen e detyrës. Në çdo rast ato duhet të njoftojnë titullarin e institucionit për çdo veprimtari të jashtme që ata kryejnë. Çdo punonjës ka detyrimin t`u përmbahet deklaratave të angazhimit për mospërfshirje në veprimtari apo aktivitete që përbëjnë konflikt interesi.

Neni 19

Etika dhe disiplina në punë

Çdo punonjës i IZHA duhet të zbatojë Ligjin nr. 9131, date 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe rregullat e përgjithshme të etikës profesionale dhe disiplinës në punë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Masat disiplinore

1. Shkelja e dispozitave të Kodit të Punës, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, të rregullores së brendshme të institucionit dhe të legjislacionit shqiptar përbën shkak për përgjegjësi disiplinore dhe për marrjen e masave disiplinore.
2. Llojet e masave disiplinore dhe procedura e dhënies së masave disiplinore përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

KREU IV

FINANCIMI

Neni 21

Financimi

1. IZHA është institucion buxhetor, që financohet nga buxheti i shtetit, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
2. IZHA financohet edhe nga burime të tjera të ligjshme, të dhëna në formë donacioni sipas projekteve të ndryshme nga institucione apo nga organizata kombëtare apo ndërkombëtare për veprimtari apo aktiviteteve që lidhen me misionin e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 22

Asetet

Të gjitha asetet në pronësi të IZHA-s ruhen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984, "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", të ndryshuar.

Neni 23

Auditimi

Veprimtaria e IZHA-së auditohet nga strukturat audituese të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe struktura të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

STEMA DHE VULA ZYRTARE

Neni 24

Stema dhe Vula zyrtare

1. IZHA identifikohet me stemën dhe vulën e saj zyrtare.
2. Stema e IZHA-s përbëhet nga Stema e Republikës dhe shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Zhvillimit të Arsimit".
3. Vulat e IZHA-s kanë formën dhe elementët e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 06.08.1993, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare", të ndryshuar, dhe shënimin identifikues "Instituti i Zhvillimit të Arsimit".
4. IZHA pajiset me dy vula, vula zyrtare apo shkresore dhe vula e sekretarisë.
5. Vulat e IZHA-s prodhohen, administrohen, ruhen dhe asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VI

DISPOZITAT TË FUNDIT

Neni 25

Miratimi

Drejtori i IZHA-s i propozon për miratim Ministrit të Arsimit dhe Shkencës statutin e IZHA-s.

Neni 26

Ndryshimi apo shfuqizimi

Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në statutin e IZHA-s bëhen me propozim të Drejtorit të IZHA-s dhe me miratimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Statuti ndryshohet apo shfuqizohet edhe kryesisht nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 27

Hyrja në Fuqi

Ky statut hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 28

Publikimi

Përmbajtja e statutit i bëhet e njohur publikut nëpërmjet publikimit elektronik në faqen zyrtare të Institutit të Zhvillimit të Arsimit.